



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01- 12856/20
Kaçanik, 16.07.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V-të** (Pestë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 16 Korrik 2020. Për shkak të distancës fizike lidhur me pandeminë, mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës –Ylber Bajra, drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani, ndërkaq nga zyrtarët ishte, Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,

Procesmbajtës: Makfëre Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e V-të (Pestë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 16 Korrik, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut;
3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhën pusët, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të KRU" Bifurkacioni" SHA Ferizaj; dhe
4. Njoftim me Raportin e MAPL për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Në emër të Grupit parlamentar të PDK të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës, kam një Kërkesë që për mbledhjen e Kuvendit të Komunës të procedohet për

shqyrtim dhe miratim, Deklarata për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit, Kush është për propozimin e shefit të GP të PDK-së z. Nexhat Loku që, Deklarata për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të procedohet për Kuvendin e Komunës. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për.

Në sajë të kësaj del konstatimi që, **Deklarata për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës në mbledhjen e datës 21 Korrik 2020.**

Deklarata e iniciuar në emër të GP të PDK, nga z. Nexhat Loku-shef i GP të PDK, iu dorëzuar Sektorit të Kuvendit për me proceduar për Kuvendin e Komunës.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhës së IV-të (Katërt) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 24 Qershor 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01- 12856/20.

2. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimit e vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Duhet pasur parasysh së ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i KK jo për të gjithë qytetarët e komunës, por për financimin shtesë të veteranëve të luftës së UÇK-së. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Në bazë të titullit të vendimit të bënë me kuptuar së është fjala për financim shtesë për të gjithë kategoritë, ndërkaq në dispozitat më poshtë qartësohet së është fjala për shtimin e financimit shtesë vetëm për veteranët e luftës së UÇK-së.

z. Ramadush Osmani, Financimi shtesë 175€ për sigurimin e arkivolit dhe sigurimin e flamurit kombëtar, këto mjete me herët janë siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, ndërkaq janë proceduar përmes OVL, mirëpo tani iu ka mbyllë llogaria e kësaj shoqate dhe mjetet shkojnë përmes kontos së Bashkësisë Islame.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka, a jeni që ky Propozim Vendim të shkoj në Kuvendin e Komunës. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut , në të cilat ndodhën pusët, rezervuarët e ujit , stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të KRU” Bifurkacioni” SHA Ferizaj;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Më intereson të di, pusët, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit, etj a janë në pronësi të komunës, kur dihet fakti së çdo objekt i vendosur në pronë të komunës është aset i komunës.

z. Ramadush Osmani- Pasi menaxhimi i ndërmarrjes kalon në nivel të ministrisë, duhet bërë regjistrimin e aseteve që ekzistojnë në Komunën e Kaçanikut. Prona është komunale, mirëpo objekti-aseti është i ndërmarrjes regjionale ‘ Bifurkacioni” në Ferizaj.

Kryesuesi i Kuvendit, Ka shumë burime të cilat nuk menaxhohen nga KRU “ Bifurkacioni”, kështu që të njëjtat duhet regjistrohen së cilat asete i menaxhon kjo ndërmarrje, cilat jo.

z. Ekrem Kyçyku, Me vet faktin së aseti është në pronë të komunës, ai është aset i komunës.

z. Ramadush Osmani, Qëllimi i komunës është më bërë evidentimin e aseteve; puseve, rezervuarët e ujit , stacionet e pompimit, ujëmbledhësit etj. pavarësisht nga kush menaxhohen.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që ky Propozim Vendim t’i adresohet KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të komunës së Kaçanikut , në të cilat ndodhën pusët, rezervuarët e ujit , stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të KRU” Bifurkacioni” SHA Ferizaj; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Njoftim me Raportin e MAPL për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

Kryesuesi i Kuvendit, Raporti është dashur me herët me ardhur në KPF dhe KK, mirëpo disa çështje kanë ngecur për shkak të pandemisë. Ky raport e nxjerrë mirë aktivitetin e Kuvendit të Komunës dhe të Kryetarit të Komunës. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Atëherë, meqë nuk u paraqit kush për diskutim, a jeni të pajtimit që ky raport të shkoj në KK sa për njoftim ? Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF u

Njoftua

Me Raportin e MAPL për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2019, dhe i njëjti i adresohet Kuvendit të Komunës në procedurë sa për njoftim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:25. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët.

Mbledhja e Kuvendit të Komunës është caktuar për datë, 21 Korrik 2020, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli